

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës -Serbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: Studime dhe projektme (Hartimi i projektit konceptual arkitektonik dhe inxhinierik për rehabilitimin e Depotit (reparteve) të mirëmbajtjes së mjeteve hekurudhore Shkozët)

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV Projekte 22114311-5

VLERA E FONDIT LIMIT: 13,186,721 (trembëdhjetë milion e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e njëzet e një) **lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kavaje ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës nr.8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros minimale për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së parashikuar të kontratës objekt prokurimi.

. Në zbatim të nenit 43, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar mësipër. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Sipas nenit 43 pka 2/b të VKM nr.285 datë 19.05.2021 ku citohet ” sa vlera e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar”

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 (Bilancet të paraqiten konform parashikimit të nenit 41 shkronja c) të Ligjit nr. 1009/2009), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori/et ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, te nje ose disa kontratave per sherbimet e kryera gjatë tre viteve

të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, si dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Operatori/et ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit teknik të shoqërisë, të afte për kryerjen e të gjitha shërbimeve sipas Termave të References për këtë objekt, si më poshtë:

- 1- Drejtues Ekipi (Menaxher Projekti) / Inxhinier Ndërtimi Diplomë universitare në Inxhinieri Ndërtimi, fusha infrastrukturë transporti
- 2- Arkitekt (Diplomë universitare në Arkitekturë)
- 3- Inxhinier Ndërtimi (strukturist) Diplomë universitare në Inxhinieri Ndërtimi (strukturist)
- 4- Inxhinier Projektues Hekurudhash (planifikues i linjave) Diplomë universitare në Inxhinieri Ndërtimi.
- 5- Specialisti i hekurudhave (sistemet e sigurisë, sinjalizim hekurudhor, specialisti i katenarëve) Diplomë universitare në Inxhinieri Ndërtimi apo inxhinier elektro-magnetik
- 6- Specialist HVAC Diplomë universitare në Inxhinieri Mekanike (enegjitike)
- 7- Specialist i mbrojtjes nga zjarri (Diplomë universitare në Inxhinieri Mekanike)
- 8- Specialist ekonomik transporti për hartimin e Analizave kosto-fitim. (Diplomë universitare në Inxhinieri apo Ekonomi)

Per stafin e sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomat / kontratë pune të vlefshme, si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë për muajin e fundit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi:

Per te provuar kapacitetet teknike dhe profesionale te shoqerise eshte kerkuar deshmi per fuqine punetore te operatorit ekonomik te nevojshem per realizimin e kontrates ne mbeshtetje te germes (b), pika 8 e Nenit 26, Seksioni II, Kreu III të VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (i ndryshuar) , si dhe në mbështetje te Ligjit Nr.9643, date 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, Neni 46, pika 1, germa (b). **Sqarojme se, numri i punonjesve eshte percaktuar referuar volumeve te punes qe do te kryhen , afatit te realizimit te kontrates objekt prokurimi si dhe grafikut te punimeve te percaktuar nga autoriteti kontraktor me qellim realizimin me sukses dhe ne kohe te kontrates**

2.3.3 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategoritë:

- **2 a,** Projektim arkitekturor per Objekte banimi- objekte industriale – objekte turistike
- **3 a,** Objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.
- **3 b,** Objekte me skelet metalik
- **4 b,** Projektim i instalimeve termoteknike, kondicionim si edhe te impianteve te prodhimit te energjise termike nga burime te rinovueshme
- **4 i,** Projektim i ndricimit rrugor, shesheve,dekorativ, ndricimit te objekteve te medha sportive, porteve, aeroporteve,etj
- **5 b,** Projektim Furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.
- **6 a,** Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore
- **6 e,** Hekurudha – degezime hekurudhore
- **8 a,** Rivelime inxhinierike
- **9 a,** Studim/Vleresim gjeologo-inxhinierik i i truallit per objekte civile- ekonomike deri ne 5 kate

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”i ndryshuar me VKM. Nr. 943 date 28.12.2016. **Ofertuesit duhet të sjellin Liçencat e rinovuara në zbatim të këtij vendimi.** (Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).*

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokument

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe *vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të*

Këshillit te Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënimpërcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Sipas këtij kriteri, operatori/ët ekonomik duhet të dëshmojë se disponon liçensat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet si më poshtë:

KATEGORIA E KËRKUAR	PËRSHKRIMI I KATEGORISË	ARGUMENTIMI
2.a	Projektim arkitekturor per Objekte banimi-objekte industriale-objekte turistike	Bazuar në shërbimet e kerkuara sipas Termave të Referencës, parashikohet kryerja e shërbimeve te lidhura me projektimin arkitekturor te objekteve te cilat jane subjekt studimi dhe projektimi. Si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
3.a	Projektim objekte civile-industriale-turistike prej murature e skelet beton arme deri ne 5 kate	Bazuar në shërbimet e kerkuara sipas Termave të Referencës, parashikohet kryerja e shërbimeve te lidhura vecanerisht me projektimin e strukturave metalike qe do jene subjekt projektimi per objekte te caktuara sipas detyres se projektimit. Si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
3.b	Objekte ne skelet metalik	Bazuar në shërbimet e kerkuara sipas Termave të Referencës, parashikohet kryerja e shërbimeve te lidhura kryesisht me projektimin e strukturave beton-arme me/pa prani të ujit, vlerësimi i ngarkesave në tubacionet, pusetave apo dhoma kontrolli, kalimet e rrugëve kryesore dhe rrjeteve inxhinierike dhe si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
4.b	Projektim i instalimeve termoteknike, kondicionim si edhe te impianteve te prodhimit te energjise termike nga burime te rinovueshme	Bazuar në shërbimet e kerkuara sipas Termave të Referencës, parashikohet kryerja e shërbimeve te lidhura vecanerisht me projektimin e instalimeve termoteknike, kondicionim, aspirim, etj (HVAC), gjithashtu edhe projektimi i impianteve te prodhimit te energjise termike nga burime te rinovueshme per objekte te caktuara sipas detyres se projektimit. Si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
4.i	Projektim i ndricimit rrugor,shesheve,dekorativ, ndricimit te objekteve te medha sportive, porteve, aeroporteve,etj	Bazuar në shërbimet e kerkuara sipas Termave të Referencës, parashikohet kryerja e shërbimeve te lidhura vecanerisht me projektimin e ndricimit rrugor, shesheve, ndricimit te objektev,etj te cilat jane te caktuara sipas detyres se projektimit. Si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.

5.b	Projektim Furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.	Bazuar në shërbimet e kerkuara sipas Termave të Referencës, parashikohet kryerja e shërbimeve të lidhura vecanerisht me projektimin e furnizimit me uje dhe shkarkimeve të kolektoreve të ujerave të zeza sipas detyres së projektimit. Si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
6.a	Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore	Bazuar në shërbimet e kerkuara sipas Detyres së Projektimit, parashikohet të kryhet projektimi i rrugeve dhe hapësirave të brendshme ku mendohet të jete i gjithë aksesit me autovetura brenda depotit. Si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
6.e	Hekurudha – degezime hekurudhore	Bazuar në shërbimet e kerkuara sipas Detyres së Projektimit, parashikohet të kryhet projektimi i linjave hekurudhore dhe degezimet perkatëse sipas detyres kryesore të projektimit. Si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është tepër e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
8.a	Rivelime inxhinierike	Bazuar në shërbimet e kerkuara sipas Termave të Referencës, parashikohet të kryhet azhurnimi i objektit dhe të gjithë hapësirës ku mendohet të kalojë sistemi i rrugeve, objekteve të shërbimit dhe linjat hekurudhore, përpara fillimit të projekt - idese. Si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
9.a	Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i i truallit për objekte civile-ekonomike deri në 5 kate	Bazuar në shërbimet e kerkuara sipas Termave të Referencës, parashikohet të kryhet Studimi dhe Raporti gjeologo-inxhinierik i i truallit për objektet dhe të gjithë hapësirës ku mendohet të kalojë sistemi i rrugeve, objekteve të shërbimit dhe linjat hekurudhore, përpara fillimit të projekt - idese. Si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.

2.4.1 Operatori/et ekonomik duhet të ketë certifikatat e mëposhtme:

- a) Operatori ekonomik paraqet Certifikatën **ISO 14001:2015** “Për Sistemin e Menaxhimit Mjedisor” (e vlefshme) ose një ekuivalente në përputhje me objektin e kontratës.
- b) Operatori ekonomik do të paraqesë Certifikatën **ISO SSH/EN 9001: 2015** për “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë” (e vlefshme) ose një ekuivalente në përputhje me objektin e kontratës.

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas fushave/ekspertizave të marra persiper për të realizuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Operatorët ekonomikë, bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, paraqesin si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe nenit 26 të VKM 285 dt.19.05.2021.